U.M.N
ARSHIVA
Nr 361 Dt 28/12/2005

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA EKONOMISE,TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE TE BRENDESHME

Blvd.Deshmoret e Kombit Nr.2, Tel:+355 4 223 383
Internet:http://www.mete.gov.al Fax:+355 4 222 472

# URDHER

Nr.266, date 27 12/2005

PER
EMERIM NE DETYRE

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.7926,date 20.04.1995" Per transformimin e ndermarrjeve ne shoqeri tregtare", neni 4, i ndryshuar;

**Urdheroj:**

1. Zoti Fatos **DARDHA**, emerohet ne detyren e Administratorit te Pergjithshem te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes"sh.p.k.Kucove.

2. Ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese dhe Drejtoria e shoqerise " Uzina Mekanike e Naftes" Kucove per zbatimin e ketij Urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI
Genc RULI

---

REPUBLIKA E SHQIPERISE
U.M.N. shpk KUÇOVE
*(Zyra e Administrates e Burimeve Njerezore )* dt. 28.12.2005

# NJOFTIM

Dega Ekonomi- Finance

Bazuar Urdherin Nr.266, dt.27.12.2005 te Ministrise Ekonomise , Tregtise dhe Energjitikes ,Tirane "Per emerim ne detyre"

N j o f t o j :

1. Z.Fatos Dardha emerohet Administrator I Pergjithshem I shoqerise Uzina Mekanike e Naftes shpk Kuçove.
2. Z.Bardhyl Gjyzeli lirohet nga detyra e Administratorit te Pergjithshem te kesaj shoqerie .
3. Bashkengjitur eshte edhe nje kopje e urdherit te Ministrise Ekonomise , Tregtise dhe Energjitikes per kete qellim
4. Ky urdher hyn ne fuqi ne dt.28.12.2005.

PERGJEGJESE E ZYRES ADMINISTRATES
Shpresa SHKEMBI

---

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE VLORE
NOTERE ANILA BARDHI
KUCOVE
NR. 366/1 REPERTORI

VERTETIM

Ne Kucove sot ne date 25.02.2010 para meje noteres Anila Bardhi ne zyren e noterise ne lagjen »Ll.Prifti » u paraqit personalisht shtetasi :

. Mitku Kuqo

madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili kerkoi vertetimin e kopjes me origjinalin e dokumentit :

Urdher per dhenie mase disiplinore

Nga verifikimi dhe krahasimi vertetoj, se njesia eshte kopje e njejte me dokumentin origjinal. Vertetimi i dokumentit u be ne baze te nenit 56 te Ligjit Nr.7829 date 01.06.1994 »Per Noterine »(Udhezimin e Ministrise se Drejtesise me Nr.6291 date 17.08.2005/pika 3,4,7).

NOTERE ANILA BARDHI

---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

# URDHER

Nr.182, Date 23.11 2005

PER

DHENIE MASE DISIPLINORE

*Nga auditimi i ushtruar ne sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove per vitet 2001- 2004 jane verejtur te meta, mangesi e shkelje ligjore, nga te cilat veçojme:*

-Ka rritje per çdo vit te nivelit te detyrimeve tatimore te pa derdhura ndaj buxhetit te shtetit. Ne fundin e vitit 2004 detyrimet jane ne vlera shume te larta: detyrimet per TVSH-ne 15.074.297 leke, tatimi mbi te ardhurat 3.350.000 leke, tatimi mbi fitimin 1.375.911 leke dhe kontributi i sigurimeve shoqerore 23.470.864 leke. Gjithesejt detyrime ndaj organeve tatimore jane per 19.8 miljon leke dhe ndaj sigurimeve shoqerore per kontributin per 38.6 milione leke (nga kjo kamate vonesa 15.2 milione leke).

-Detyrimet debitore te pa arketuara per Uzinen Mekanike te Naftes Sh.P.K. Kuçove ne fundin e vitit 2004 jane 121.136 mije leke, prej te cilave 90.4 % zene detyrimet me afat krijimi nga 1-5 vjet (109.574 mije leke).

-Auditimi ka konstatuar shkelje dhe parregullshmeri te perseritura ne zbatimin e proçedurave te prokurimit, te cilesuara ne:

- mos dergimin e programit te prokurimeve ne Agjensine e Prokurimit Publik,
- mos percaktimin e drejte te procedures se prokurimit,
- aplikimin e shtesave te kontratave te prokurimeve per nivelin 30 % te kontratave te mepareshme, pa marre miratim ne Agjensine e Prokurimit Publik,
- mungesen e perllogaritjeve apo argumentimeve per percaktimin e fondit limit,
- tejkalime te kufirit te blerjeve me vlefta te vogla dhe mosrespektim te kufirit vjetor te prokurimit per nje artikull (300 mije leke). Keto veprime jane ne kundershtim me kerkesat e Ligjit Nr. 7971, date 26.07.1995 "Per Prokurimin Publik", te Vendimit te Keshillit Ministrave Nr. 335, date 23.06.2000 "Per rregullat e Prokurimit Publik" si dhe te Udhezimit te Keshillit te Ministrave Nr. 1, date 01.01.1996 "Per prokurimin publik " dhe ngarkojne me pergjegjesi Administratorin e Pergjitheshem, z. Bardhyl Gjyzeli.

*Per sa siper*, **mbeshtetur ne nenin 55 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" me ndryshimet, ne Statutin e Shoqerise, ne Ligjin Nr. 7961, date 12.07.1995 "Per Kodin e Punes I Republikes se Shqiperise" me ndryshimet si dhe ne Ligjin Nr. 9009, date 13.02.2003 "Per auditimin e brenshem ne sektorin publik",**

**URDHEROJ:**

1. Te largohet nga detyra e Administratorit te Pergjitheshem te sh.p.k "Uzina Mekanike e Naftes" Kuçove, z. Bardhyl Gjyzeli.

2. Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve ne ministri te marre masa per zbatimin e ketij urdheri.

*-Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.*

MINISTRI
GENC RULI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**
**DREJTORIA E PERGJITHSHME SHERBIMEVE MBESHTETESE**
**DREJTORIA E SHERBIMEVE TE BRENDSHME**

---

# URDHER

**Nr 136 date 07.12 / 2010**

**PER**

**LIRIM DHE EMERIM NGA DETYRA**

Mbeshtetur ne nenin 102 pika 4 te Kushtetutes ne Republiken e Shqiperise, Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 *"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "*, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

**URDHËROJ:**

1. Z. Abdulla Xhemo, Drejtor i shoqerise *"Uzina Mekanike e Naftes"*Sh.p.k Kucove, lirohet nga detyra.
2. Mardheniet financiare dhe ato te punes, per z. Abdulla Xhemo te rregullohen sipas legjislacionit ne fuqi.
3. Z. Selfo Kapllani, diplomuar ne Universitetin e Tiranes - Fakulteti Gjeologji – Miniera, Dega Inxhinieri Shpimi, emerohet Drejtor i shoqerise*"Uzina Mekanike e Naftes"* Sh.p.k Kuçove.
4. Marredheniet financiare per z. Selfo Kapllani fillojne me paraqitjen ne detyre.
5. Bazuar ne Ligjin nr. 9723, date 03.05.2007,*"Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit"*, ngarkohet Drejtoria e shoqerise *"Uzina Mekanike e Naftes"* Sh.p.k Kuçove per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**MINISTRI**

**DRITAN PRIFTI**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001 / Tel +355 4 2228241 / Fax +355 4 2234052 / E-mail: Dshb @mete.gov.al / Faqja web: http://www.mete.gov.al